

University of Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Spring 3-2021

SISTEMI FINANCIAR NË KOSOVË

Hatije Luri

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the **Business Commons**



Kolegji UBT

Fakulteti Menaxhment Biznes dhe Ekonomi

SISTEMI FINANCIAR NË KOSOVË

Shkalla Bachelor

Hatije Luri

Mars/2021

Prishtinë



Kolegji UBT
Fakulteti Menaxhment Biznes dhe Ekonomi

Punim Diplome

Viti akademik 2015/16

Hatije Luri

SISTEMI FINANCIAR NË KOSOVË

Mentori: Prof. Dr. Bukurije Jusufi

Mars/2021

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Sistemi financiar është, pa as më të voglin dyshim, katalizatori apo më saktë, laboratori ku zhvillimet ekonomike marrin formën dhe trajtën e duhur. Nuk mund të teprohet dhe të identifikohet ekonomia me sistemin financiar të një vendi. Por, nuk mund të neglizhohet dhe as të pakësohet roli i pazëvendësueshëm i sistemit financiar në zhvillimin dhe begatinë ekonomike të një ekonomie kombëtare. (Bundo, Luci, & Cane, 2002).

Ky përkufizim shpreh më së miri rolin kryesor të një sistemi financiar për ekonomin e një vendi.

Në botë sot njihen dy orientime të mëdha të sistemit financiar, ai i orijentuar nga tregu dhe sistemi financiar i orientuar nga bankat. Diskutime të shumta, studime ekonometrike të specialistëve të fushës, kanë dashur të vendosin në pedestal njërin prej këtyre sistemeve, për ta planifikuar dhe për ta cilësuar si një shembull për të ndjekur me qëllim që të kemi rritje ekonomike në rang botëror. Me anë të kesaj detyre kurr sigurisht nuk mund të pretendojmë të ndërtojmë një model ekonometrik për të arritur në konkluzione reale, por jemi përpjekur që të rishikojmë literaturat dhe kërkimet shkencore të profesorëve të ndryshëm, në mënyrë që të ndërtojmë një kornizë të qartë të secilit prej sistemeve.

Fjalët kyçe: Sistemi Financiar, Sistemi Bankar, Ekonomia, Financa, Performanca.

MIRËNJOHJE DHE FALENDËRIME

Mirënjohje dhe falenderime për familjarët e mi, të cilët besuan fuqishëm në përkushtimin Tim. Jam pafundësisht e lumtur që arrita të realizojë një nga objektivat kryesore që kisha në jetë. Mirëpo këtë sukses nuk do e kisha arritur pa ndihmën e familjes, miqëve dhe padyshim të mentorit Tim të temës prof.Dr.Bukurije Jusufi.

Një falenderim të veçantë i kushtoj gjithë stafit akademik të Fakultetit të Menaxhment Biznes dhe Ekonomi, për mundësinë që më dhanë të arrij të plotësoj graduimin Tim, në sajë të korrektësisë dhe përkushtimit, si dhe falë ndihmesës dhe bashkëpunimit të lartë shkencor e profesional. Falemnderit që u bëtë pjesë e formimit dhe mbështetjes sime dhe që më krijuat mundësinë që të Jap edhe unë një ndihmesë modeste duke u diplomuar në programin bachelor në Menaxhment Biznes dhe Ekonomi.

FJALORI I TERMAVE

BQK	Banka Qendrore e Kosovës
RKS	Republika e Kosovës
PF	Performanca Financiare
OJQ	Organizatë joqeveritare
SPN	Sistemi Ndërbankar i Pagesave
OEK	Oda Ekonomike e Kosovës
SI	Sistemi Financiar
SB	Sistemi Bankar

PËRMBAJTJA

ABSTRAKT I

LISTA E FIGURAVE..... VI

LISTA E TABELAVE VII

HYRJE 1

2. SHQYRTIMI I LITERATURËS..... 3

2.1. Historiku i Bankave 3

2.2. Çka janë Bankat? 3

2.3. LLOJET E BANKAVE 5

2.4. Banka Qendrore e Kosovës (BQK) 7

2.4.1. Vizioni strategjik i BQK-së 8

2.4.2. Funksioni I BQK-së..... 8

2.4.3 BQK-ja si agjent bankar 9

2.4.4. Roli I politikës monetare të BQK-së 9

2.4.5. Furnizimi me kartëmonedha dhe monedha 10

2.4.6. Sistemet e pagesave 11

2.4.8. Menaxhimi i mjeteve 12

2.4.9. Emetimi i letrave me vlerë të qeverisë 13

2.5. Operacionet Bankare 15

2.5.1. Ndarja e punëve bankare sipas kriterit funksional..... 15

2.5.2. Ndarja e punëve bankare sipas kriterit të afatit 16

2.5.3. Ndarja e punëve bankare sipas kriterit të bilancit analitik. 16

2.6. FUNKSIONET E BANKAVE 17

2.6.1. Funksioni i krijimit të parave..... 17

2.6.2. Funksioni i ndërmjetësimit financiar 18

2.7. Roli i Sektorit Bankar në Kosovë 19

2.7.1. Sektori Bankar në Kosovë – Norma e interesit 20

2.7.2. Shërbimet Bankare 20

2.7.3. Depozitat dhe shpërndarja e tyre në sektorë.....	20
2.7.4. Kreditë dhe shpërndarja e tyre në sektorë	21
2.7.5. Likuiditeti i Bankave	21
2.7.6. Aplikimet për licencimin e bankave të reja	21
2.8. Përshkrimi I Rezultatit të Hulumtimit	22
3. DEKLARIMI I PROBLEMIT	28
4. METODOLOGJIA	29
5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	31
REFERENCAT	33

LISTA E FIGURAVE

Figure 1 Llogo e BQK-së.....	8
Figure 2 Sistemi i Pagesave.....	11
Figure 3. Sistemi Ndërbankar i Pagesave SNP	13
Figure 4 Sektori Bankar në Kosovë	19
Figure 5 Përqindja e Gjinisë të anketuarve	23
Figure 6 Përqindja e moshës së të anketuarve.....	23
Figure 7 Përqindja se a keni ndëgjuar për sistemin financiar në Kosovë.....	24
Figure 8 Përqindja se sa jeni të kënaqur me sistemin financiar në Kosovë.....	24
Figure 9 Përqindja se a mendoni se ka pasur përmirsim në sistemin financiar në Kosovë	25
Figure 10 Përqindja se a mendoni që BQK do të ndikonte në përmirsimin e sistemit financiar në Kosovë	Error! Bookmark not defined.
Figure 11 Përqindja se si e vlersoni sistemin financiar në Kosovë ju qytetarë.....	Error! Bookmark not defined.
Figure 12 Përqindja se sa shpesh përballeni me probleme në këtë fushë	Error! Bookmark not defined.
Figure 13 Përqindja se a mendoni që do të ketë përmirsim sistemi financiar në Kosovë në vitin 2021	Error! Bookmark not defined.

LISTA E TABELAVE

Table 1 Gjinia e të anketuarve	30
Table 2 Moshë e të anketuarve.....	311
Table 3 A keni ndëgjuar për sistemin financiar në Kosovë.....	313
Table 4 Sa jeni të kënaqur me sistemin financiar në Kosovë	319
Table 5 A mendoni se ka pasur përmirsim në sistemin financiar më Kosovë	233
Table 6 A mendoni që BQK do të ndikonte në përmirsimin e sistemit financiar në Kosovë.....	233
Table 7 Si e vlerësoni sistemin financiar në Kosovë ju qytetarë.....	244
Table 8 Sa shpesh përballeni me probleme në këtë fushë.....	244
Table 9 A mendoni që do të ketë përmirsim sistemi financiar në Kosovë në vitin 2021	255

1. HYRJE

Funksionet që sot përfshihen në sistemin bankar kanë origjine antike. Zakonisht pasuritë të mëdha ruheshin në tempuj ose u besoheshin priftërinjve të rëndësishëm. Greqia konsiderohet si djepi i bankave pasi pikërisht atje janë kryer veprimet të para bankare të dokumentuara. Në mesjete përveç huadhënies në para, kanë ekzistuar huadhëniet në natyre, madje dhe me norma interesi. Njerëzit e pasur vepronin me a letra kredie në baze të se cilave paguhej prurësi më të parë. Veprohej në këtë mënyre në rastet kur behej fjale për shuma të mëdha ose mallra me vlere.

Letra kredisë ishte paraardhësja e çekut të sotëm që mundësoi pasurimin me ritme gjigante të bankiereve të asaj kohe sidomos të atyre që ushtronin aktivitetin në qytete të mëdha tregtare si Firence apo Amsterdami. Madje disa u bene aq të pasur sa arritën deri të lëshonin hua për familje fisnikesh, por edhe për mbretër të cilët në raste kur nuk ishin në gjendje të kthenin paratë jepnin tituj fisnikërie. Si shembull konkret mund të përmendim :

- bërjen Pape të një anëtar të familjes Medici (familje shumë e njohur) dhe
- emërimin Zot i Firences i Lorenzo il Magnifico (edhe ky rrjedh nga familja Medici).

Banka është ndërmarrje me specifika në afarizmin e sajë, të cilat janë të rregulluara me veprime, praktika dhe dispozita specifike. Ajo bën marrjen e kursimeve, dhënjen e kredive, ndërmjetësimin e pagesave në ekonomi dhe shoqëri. Fjala bankë, supozohet se rrjedh nga fjala Italiane „banco” që në përkthim do të paraqiste një tezgë të vendosur, dhe në historikun e sajë filloi kështu; kur këtë punë e kryenin „tezauret”. Edhe sot përdoret shprehja „tezaurim” që ka nocionin e disa punëve të shpejta të grumbullimit të instrumenteve apo produkteve bankare.

Funksioni i parë ishte këmbimi, apo ndërrimi i parave të ndryshme të atëherëshme metalike, me kualitet dhe peshë të ndryshme. Por po ashtu ishte edhe depozitimi dhe ruajtja e parave. Që atëherë, por edhe sot punët e arkëtimit, ruajtjes, dhe të ndërmjetësimit, duke ua shtuar

atyre edhe punët kreditore, janë veprimtarija kryesore e bankave. Në sistemet e mëherëshme, skllavopronarë dhe feudal, funksioni i bankave ishte për ndërmjetësim dhe depozitim, ndërsa në atë kapitalist përveq tjerash, kreditimi është funksion primarë.

2. SHQYRTIMI I LITERATURËS

2.1. Historiku i Bankave

Bankat e kanë një origjinë të vjetër që nga kohërat antike, qindar e mijëra blloqe në formë pyke janë zbuluar nga arkeologët në vende të ndryshme të qytetit të Babilonisë, përgjatë lumit Tigër dhe Euftrat, shumë prej të cilave ishin pranimet e depozitave dhe kontratave monetare që konfirmojnë ekzistencën e operacioneve të thjeshta bankare si: Punët e përditshme, të zakonshme dhe të përhapura në të gjithë Babiloninë. Po ashtu Romakët, sindërtues të mëdhenj dhe administrator në të drejtën e tyre, I nxorën bankat nga tempujt dhe i vendosën ato Brenda ndërtesave të dallueshme, edhe me shpërbërjen e Perandorisë Romake, përfundimisht disa prej institucioneve të saj bankare jetuan në formën e bankierëve pa pale që dolën në perandorinë e Shenjtë Romake, dhe me kalorësit e tempullit gjatë kryqëzatave. Sa i përket Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bankat janë ndër bizneset më të vjetra në historitë amerikane. Banka e Nju Jorkut, për shembull, u themelua në vitin 1784 dhe së fundi është riemëruar si Banka e New York Mellon. Ajo kishte përvjetorin e saj të 225 në vitin 2009. Sistemi banker është një nga më të vjetrit, më i madh dhe më i rëndësishmi në industrinë amerikane. (Sylla, 2014)

2.2. Çka janë Bankat?

Në teorinë e financave egzistojnë përkufizime të ndryshme për bankat si institucione financiare. Bankat për nga përmbajtja dhe funksioni i tyre dallohen nga subjektet e tjera ekonomike. Përkufizimi i bankës është i lidhur me funksioni që kryen ajo në riprodhimin e zgjeruar dhe në sferën e transaksioneve. Në këtë drejtim mund të themi se Banka paraqet institucionin financiar të veçant, i cili merret me mobilizimin e mjeteve monetare përkatësisht me ndërmjetësimin e marrjes dhe të dhënjes së kredive dhe qarkullimit të pagesave të komitentëve. Me fjalë të tjera Banka është institucion financiar që bën marrjen dhe dhënjen e kredive. Pra, Banka si institucion ndërmjetsues financiar bënë mobilizimin e

mjeteve të lira popullore, të ndërmarrjeve dhe subjekteve të tjera ekonomike dhe ato ua huazon në form kredie personave fizik apo juridik. Në të vërtetë bankat janë institucione financiare që bëjnë transferin e parasë nga huadhënsit te huamarrsit. Kështu, marrja dhe dhënja e kredisë paraqet veprimtarin thelbësore të bankës. (Limani, 2002)

➤ **Shërbimet e caktuara qe kryen banka:**

- a) marrja (pranimi) e depozitave
- b) dhënja e kredive (huave)

Pranimi i depozitave. Për ta realizuar funksionin e saj Banka në radhë të parë, bën pranimin e depozitave si nga ndërmarrjet ekonomike ashtu edhe nga individët (popullata). Depozitat përfaqesojnë deponimin e parave të lira (kursimeve) në bankë si nga personat juridik ashtu edhe nga ata fizikë. Kemi disa lloje depozitave:

- **Depozita të paafatizuara** – në të parë. Këto mjete prnar i tyre mund ti shfrytëzoj në qdo momet, të cilat mund të kthehen në para të gatshme ose shërbejn për të bër pagesa të ndryshme. Depoziti në të par funksionon plotësisht si mjet këmbimi dhe pronari I tyre mund ti përdot në formë transaksioni në qdo moment deri në sasin e vlerës përkatëse. Për këto depozita Banka ofron norm ate ulta të interesit.
- **Depozita me afat.** Me këtë rast ndërmjet bankes dhe depozituesit lidhet kontrata në të cilën përcaktohet koha e afarizmit dhe elementet e tjera që dalin nga ku lloj depoziti. Këtu depozituesi nuk mund ti tërheq në formë paraje oe të bëj pagesa Brenda kohës së afatizuar, por vetëm pasi të skadoj ky afat. P.sh nëse ju keni depozituar në një bank afariste 5.000 \$ në një afat dy vjet. Këto mjete nuk mund ti shfrztëzoni mbrenda këtyre dy viteve. Nëse e prishni kontratën e afarizmit të mjeteve të deponuara, jeni të detyruar të paguani një gjobë, e cila përcaktohet ,e rastin e nënshkrimit të kontratës. Për këto depozita norma e interesit është dukshëm më e madhe se për depozitat në të parë

Dhënja e kredis (huasë). Funksionin tjetër me rëndësi i bankës është dhënja e kredive. Këtu përparsia e bankës, qendron në faktin se ajo huamarrsit i ofron mjete në sasi shumë më të madhe se sikur ai të kërkonte prej individëve. P.sh qfar do të ndoshte sikur nje korporat (ndërmarrje), tu drejtohet vazhdimisht zotruesëve individual te kursimeve të marrë një kredi

(hua) në vler të caktuar parash. Në këtë drejtim avantazhet e bankës mbështeten në atë se ajo pranon depozita të shumë zotruessve të kursimeve (parave), d.m.th. Mobilizon mjetet e lira monetare dhe kështu krijon shuma të mëdha të kredisë. Në këtë mënyr bankat bankat mundësojnë zhvillimin ekonomi, duke krijuar kushte matriale për kontinuitetin e procesit të riprodhimit, në kuptimin e modernizimit të kapaciteteve egzistuese, zgjerimin dhe ngritjen së kapaciteteve të reja. (Limani, 2002)

2.3. LLOJET E BANKAVE

Më herët kanë dominuar Banka e tipit universal që janë marrë me të gjitha punët bankare, mirpo me zhvillimin e forcave prodhuese bëhet specializimi gjithnjë e më i madh i bankave. Ndarja e bankave bëhet sipas shumë kritereve p.sh sipas degëve ekonomike të cilat Banka u jep kredi, sipas afatit të punëve etj. Mirpo kriteri më i përhapur për klasifikimin e bankave është se si ato i sigurojnë mjetet e nevojshme financiare. Në bazë të këti kriteri bankat ndahen:

- ✓ Banka emituese (qendrore)
- ✓ Banka komerciale (depozitare)
- ✓ Banka afariste
- ✓ Banka intensive
- ✓ Banka të specializuara ose të degëve
- ✓ Banka univerzale
- ✓ Banka hipotekare
- ✓ Banka regjionale dhe banka për zhvillim
- ✓ Banka multinacionale dhe kursimore

➤ **Banka emituese (Qëndrore)** Banka Qëndrore është Banka kyesore e sistemit financiar e cila ka për detyrë të rregullojë mardhënjet monetare dhe kreditore të vendit. Karakteristika e veçantë e Bankës Qëndrore që dallon nga bankat e tjera është e drejta momopolistike e imitimit të parasë dhe se Banka Qëndrore nuk e ka për qëllim

fitimin, mirpo ajo me politikat e saj mundohet të ruaj stabilitetin monetar e kreditor dhe të rregulloj qarkullimin monetar të vendit.

Funksionet (punët) kryesore të Bankës Qëndrore janë:

- Emisioni i parave (monedhave dhe kartmonedhave) dhe kreditë
- Zbaton politikën monetare-kreditore, e cila ka të bëjë me rregullimin e sasis së parave në qarkullim
- Kujdset për likuiditetin kombëtar duke përcjell vazhdimisht bilancin e pagesave dhe duke zbatuar vazhdimisht masa të ndryshme në politikën devizore
- Kryen punë në llogari të shtetit
- **Banka Komerciale (depozitare)** Janë Banka që bëjnë kreditim afatshkurtër të prodhimit dhe konsumit. Këto Banka i krijojnë prej depozitave afatshkurtër të ekonomisë dhe depozitave të kursimit të popullsisë. Janë të shumta në botë janë bazë e sistemit të ndërmjetsimit financiar, sepse me punë e tyre i mobilizojnë dhe pastaj i lejojnë kredi për plotësimin e nevojave të ekonomisë duke e bërë kreditimin afatshkurtër ato njëkohësisht bëjnë emisionin e parave duke ndikuar kështu në ndryshimin e masës monetare dhe likuiditetin e vendit
- **Bankat Afariste** Paraqiten në vendet më të zhvilluara këto Banka disponojnë kapitale të mëdha dhe bëjnë kreditimin e ndërmarrjeve gjigante industriale. Karakteristikë e bankave të mëdha afariste është bashkëpunimi shumë i ngushtë me industrinë, përshtatjen e afarizmit kërkesave të tregut dhe komiteteve të saj, dhënjet e kshillave gjat financimit të projektit
- **Bankat Intensive** Janë organizata të specializuara bankare për kreditimin afatgjatë. mjetet i siguron duke dhënë fletobligacionet, me anë të afarizmit të depozitave intensive të ekonomisë
- **Bankat e specializuara ose të degëve** Themelohen për financimin e degëve të ndryshme të ekonomisë (industries, bujqësisë, zejtarisë, tregtis së jashtme).
- **Bankat univertuale** Janë Banka të tipit të përzier, të cilat merren me gjitha punët bankare. Këto kryen të gjitha punët në sferën e paras, si dhe bëjnë kreditimin e ekonomisë dhe popullsisë.

- **Bankat hipotekare Janë** organizata bankare pr kreditimin afatgjat është kategori e veqant e bankave intensive. Këto Banka japin kredi afatgjat për industri, bujqësi për ndërtim etj. Për sigurimin e kthimit të mjeteve kërkohet lënja peng e pasuris së patunshme
- **Banka regjionale dhe Banka për zhvillim** Janë Organizata bankare, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në një teritor të caktuar me qëllim të financimit të investimeve në ekonomi dhe infrastruktur.
- **Banka multinacionale** Janë organizata bankare të cilat mobilizojnë mjete me bashkomin e kapitaleve të njohura botërore. Këto Banka lejojnë të gjitha llojet e kredive, kryejn punët me lidhje me letë me vlerë, u japin informata organizative monopolistike ndërkombëtare etj.
- **Kursimorja** Është formë e veqant e organizatës bankare, që zhvillon kursimin dhe mbledh depozitat e kursimit të shtresave të gjëra të popullsis, mban llogarit rrjedhëse dhe gjyrollogarit e qytetarëve dhe bënë kreditimin e popullsis. (Komoni, 2012)

2.4. Banka Qendrore e Kosovës (BQK)

BQK është Banka qendrore e Kosovës. Ajo u themelua në qershor 2008, në të njëjtin vit kur Kosova e shpalli pavarësinë e saj nga Serbia, me miratimin e *Ligjit Nr. 03/L-074* për *Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës* nga Kuvendi i Kosovës. Para se të themelohej si Banka Qendrore e Kosovës, ajo funksiononte si Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës. Valuta zyrtare në Kosovë është euro, e cila është miratuar në mënyrë të njëanshme në vitin 2002 megjithatë, Kosova nuk është anëtare e Eurozonës. Selia e BQK-së është e vendosur në kryeqytetin e Kosovës, Prishtinë.



Figure 1 Llogo e BQK-së

Burimi: BQK

2.4.1. Vizioni strategjik i BQK-së

Vizionet strategjike të BQK-së janë të japë një kontribut të veçantë dhe të vlefshme për qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e sektorit financiar në Kosovë, të jetë në mesin e bankave qendrore më efikase dhe efektive në rajon dhe të kontribuojë në proceset e nevojshme që Kosova të bëhet anëtare e plotë e organizatave të tjera ndërkombëtare të BE-së. Nga ana operacionale, BQK-ja përpiqet të arrijë nivelin më të lartë, deri në përsosmëri, për nga kompetencat, integriteti, efikasiteti dhe transparencat në të gjitha operacionet dhe aktivitetet e saj.

2.4.2. Funkzioni I BQK-së

Funksionet e BQK-së: siç ndodh shpesh në vende relativisht të vogla, BQK-ja ka një gamë të gjerë të funksioneve. Ato kryesoret janë:

- Të nxisë dhe të mbajë një sistem financiar stabil;
- Të veprojnë si bankë ndaj bankave komerciale, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe ndaj sektorit publik dhe agjencive ndërkombëtare;

- Të zbatojë politikën monetare në Kosovë, kryesisht duke ndikuar në shumën e kredisë së krijuar;
- Të sigurojë një furnizim adekuat dhe cilësor me kartëmonedha dhe monedha në Kosovë;
- Të rregullojë dhe verë në veprim sisteme pagesash jo-kesh;
- Të licencojë, mbikëqyrë dhe rregullojë një gamë të gjerë të institucioneve financiare;
- Të menaxhojë rezervat valutore të vendit;
- Të veprojë si agjent fiskal i Qeverisë;
- Të përgatisë dhe publikojë statistika si dhe të përgatisë dhe të publikojë analiza ekonomike mbi ekonominë e Kosovës.

2.4.3 BQK-ja si agjent bankar

Banka Qendrore e Kosovës vepron si bankë, por nuk hap llogari bankare për qytetarët apo kompanitë kështu që nuk është si bankat komerciale. Konsumatorët e BQK-së janë bankat komerciale dhe institucionet e tjera financiare që veprojnë në Kosovë, Qeveria e Kosovës dhe agjenci të tjera të sektorit publik në Kosovë dhe institucione të huaja financiare dhe qeveri. Totali i depozitave të këtyre konsumatorëve që aktualisht ruhen në BQK është rreth 1.5 miliardë euro.

2.4.4. Roli I politikës monetare të BQK-së

Për shkak se Kosova përdor euron si monedhë të sajën të brendshme dhe për shkak se tregjet financiare në Kosovë janë ende relativisht të pazhvilluara, roli i politikës monetare të BQK-së është më i kufizuar nga sa është për shumë banka të tjera qendrore. Por BQK-ja ushtron ndikim në zhvillimet ekonomike në Kosovë në dy mënyra të rëndësishme.

- Së pari, ajo ndikon në rritjen e kredisë së bankave komerciale duke u imponuar bankave kërkesën për rezerva si dhe përmes rregulloreve të tjera mbi operacionet bankare.
- Së dyti, ajo përpiqet të promovojë dhe ruajë një sektor financiar të qëndrueshëm dhe efikas në Kosovë përmes licencimit, rregullimit dhe mbikëqyrjes së bankave, kompanive të sigurimeve dhe të organizatave mikro-kreditore dhe përmes punës së një Komiteti Këshillues të Makro-Prudencës që është themeluar kohët e fundit. Roli i ruajtjes së stabilitetit financiar do të përshkruhet në artikullin e ardhshëm të kësaj serie.

2.4.5. Furnizimi me kartëmonedha dhe monedha

BQK-së rrallë i duhet të importojë kartëmonedha dhe monedha euro në Kosovë për të mbajtur një furnizim adekuat të valutës euro në Kosovë, mbasi një sasi e konsiderueshme e Euros hyn në Kosovë përmes tregtisë dhe dërgesave nga kosovarët që jetojnë jashtë vendit. Por një nga qëllimet strategjike të BQK-së është të mbajë monedhë të një cilësie të lartë në Kosovë. Ajo e bën këtë duke importuar dhe nxjerrë në qarkullim kartëmonedhat e reja euro dhe duke tërhequr nga qarkullimi kartëmonedhat e vjetra e të papërshtatshme dhe bën dërgimin e tyre përsëri në Euro sistem. Për shembull, gjatë vitit 2013, BQK-ja tërhoqi nga qarkullimi gati 6 milion kartëmonedha euro (38% e kartëmonedhave euro të depozituara nga bankat në BQK) për shkak se ata nuk i plotësonin standardet e cilësisë të lartë të BQK-së. Valutën e papërshtatshme ose të tepërt Euro që BQK-ja e merr nga bankat komerciale ua kthen bankave në Eurozonë, në këtë mënyrë duke shtuar rezervat e shkëmbimit valutë në vend. Gjithashtu në vitin 2013, BQK-ja hodhi në qarkullim pak më shumë se 4 milion kartëmonedha euro për bankat. Shumica nga këto kartëmonedha janë furnizuar bankat për përdorim në ATM-të e tyre. (BQK, 2010)

2.4.6. Sistemet e pagesave

Zhvillimi i një sistemi efikas, të sigurt dhe të qëndrueshëm të pagesave kombëtare ka qenë një nga arritjet kryesore të BQK-së gjatë viteve të fundit. BQK-ja themeloi Sistemin Elektronik të Kliringut Ndër-bankar (SEKN) në vitin 2002. Ky është i vetmi sistem i pagesave ndërbankare në Kosovë. Vëllimi i transaksioneve që realizohen përmes SEKN është rritur në mënyrë të vazhdueshme që nga vënia e tij në përdorim. Rreth 6, 8 milion transaksione me një vlerë prej 6.5 milion eurosh janë realizuar përmes SEKN në vitin 2013. Mesatarisht, rreth 34,000 transaksione ndërbankare me vlerë 26 milionë euro janë realizuar nga SEKN çdo ditë. Sistemi ka funksionuar pa probleme operationale, rregullatore apo të shlyerjes që nga vënia e tij në përdorim në vitin 2002. (BQK, 2020)




Figure 2 Sistemi i Pagesave

Burimi: BQK (2017)

2.4.7. Regjistri i kredive

BQK-ja krijoi Regjistrin e Kredive (RKK) në vitin 2006. RKK-ja është në pronësi të BQK-së dhe është i vetmi regjistër i kredive që vepron në Kosovë. BQK-ja, si Banka qendrore e vendit, mund të kërkojë të gjitha institucioneve financiare të licencuara të ofrojnë të dhënat e tyre kreditore për këtë regjistër. BQK-ja mbledh informacionin, qoftë pozitiv apo negativ, nga të gjithë huamarrësit, qofshin fizik apo ligjor, nga të gjitha institucionet kreditore të licencuara nga BQK-ja. Kjo do të thotë se të dhënat në Regjistrin e BQK-së janë të plota dhe të besueshme mbasi pothuajse të gjitha të dhënat mbi huatë dhe garancitë e lëshuara në Kosovë janë futur në Regjistër. Institucionet kreditore mund të qasen në RKK për të mësuar rreth aftësisë kreditore të huamarrësit para se të marrin vendimin për dhënien e një kredie të re. Kjo duhet të rrisë qëndrueshmërinë e kreditimit në Kosovë. RKK-ja gjithashtu rrit disiplinën huamarrëse pasi huamarrësit e dinë që çdo informacion negativ në lidhje me shërbimin e kredive të tyre aktuale do të jetë në dispozicion për të gjithë huadhënësit. (BQK, 2012)

2.4.8. Menaxhimi i mjeteve

BQK-ja administron një sasi të madhe të mjeteve (aseteve) të jashtme qoftë mjete e saj apo te institucioneve tjera. Shumica e fondeve që BQK-ja i menaxhon u përkasin institucioneve të Qeverisë së Kosovës, si Ministrisë së Financave dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit, bankave komerciale dhe institucioneve të tjera financiare që përdorin si bankë BQK-në.

BQK-ja ka një Politikë të detajuar të Investimeve që është miratuar nga Bordi Ekzekutiv i BQK-së dhe shqyrtohet në baza të rregullta në mënyrë që të përshtatet me ndryshimet në kushtet e tregut financiar ndërkombëtar. Qëllimet më të rëndësishme të Politikës së Investimeve janë të ruhet siguria dhe likuiditeti i asetëve nën menaxhim. BQK-ja investon kryesisht në asete të denominuara në euro, në mënyrë që të shmangët rrezikun e humbjes nga kursi i këmbimit. Ajo gjithashtu miraton politika të forta në klasifikimin e kredive dhe

likuiditetin e mjeteve (aseteve) të cilat mund ti investojë. BQK-ja administron rrezikun e kredisë në portofolin e saj përmes një politike aktive të diversifikimit.




Figure 3. Sistemi Ndërbankar i Pagesave SNP

Burimi: BQK (2009)

2.4.9. Emetimi i letrave me vlerë të qeverisë

BQK-ja vepron gjithashtu edhe si agjent për Qeverinë e Kosovës duke emetuar letra me vlerë të qeverisë. BQK-ja tregton letrat me vlerë me anë të një sistemi ankandi. Ankandi i parë u zhvillua më 17 janar 2012 dhe që atëherë BQK-ja ka kryer më shumë se 40 ankande të mëtejshme në emër të qeverisë. Pjesëmarrësit kryesorë në ankandet janë bankat e Kosovës dhe Fondi Pensional i Kursimeve të Kosovës.

Fillimisht, BQK-ja ka nxjerrë në ankand vetëm bono të thesarit afatshkurtër. Por, gradualisht, maturiteti i tyre është zgjatur dhe kohët e fundit BQK-ja ka emetuar me sukses Letrën e parë me vlerë të Qeverisë me maturim dy vjeçar. Sistemi i ankandit të tregtimit të tyre ka funksionuar me shumë sukses dhe ka përmirësuar kapacitetin e qeverisë për të menaxhuar flukset e parasë dhe për të financuar shpenzimet e saj. Shuma e ofertave të pranuar e kanë tejkaluar shumën e letrave me vlerë në dispozicion në pothuajse të gjitha ankandet. Qeveria gjithashtu ka qenë shumë e kënaqur me rezultatet e normës së interesit të ankandëve pasi shumica e bonove dhe letrave me vlerë janë të emetuara me norma interesi nën 2%.

Statistikat ekonomike dhe hulumtimet: bankat qendrore janë shpesh një nga institucionet më të rëndësishme në një vend për prodhimin dhe publikimin e statistikave ekonomike dhe kryerjen dhe publikimin e analizave ekonomike dhe hulumtimeve. BQK-ja nuk bën përjashtim. BQK-ja rregullisht publikon dhe shpërndan një koleksion të gjerë të statistikave në sektorin financiar, sektorin e jashtëm, atë fiskal dhe real të ekonomisë së Kosovës në ueb-faqen e saj në baza periodike, Buletinin Mujor Statistikor, si dhe publikimet që bën në faqen e internetit të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe atë të Bankës Botërore. Statistikat nën përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të BQK-së janë statistikat monetare dhe financiare dhe statistikat e sektorit të jashtëm. Këto statistika janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të përcaktuara nga FMN-ja, Banka Qendrore Europiane, Eurostat, etj.

BQK-ja publikon rregullisht një koleksion të gjerë të statistikave në sektorin financiar, në atë të jashtëm, atë fiskal dhe real të ekonomisë së Kosovës në ueb faqen e saj dhe në një Buletini Mujor Statistikor. BQK-ja i jep theks të veçantë statistikave të sektorit financiar dhe atyre të sektorit të jashtëm pasi këto përpilohen nga vetë BQK-ja.

BQK-ja publikon gjithashtu edhe një sërë analizash të rëndësishëm ekonomik dhe hulumtime në publikime të rregullta të tilla si Vlerësimi tremujor i Ekonomisë, Buletinet e Bilancit të Pagesave, Raporte te Stabilitetit Financiar, Raporti Vjetor i BQK-së dhe analiza periodike. BQK-ja është duke planifikuar të rrisë gamën dhe sasinë e punës që bën në këtë fushë të rëndësishme si për të përmirësuar cilësinë e informacionit ekonomik që përdor në marrjen e vendimeve të veta politike ashtu dhe për të siguruar të dhëna të vlefshme ekonomike dhe analiza për hartuesit e tjerë të politikave në Kosovë, për sektorin e biznesit në Kosovë dhe për investitorët e mundshëm të huaj. (RKS, 2011)

2.5. Operacionet Bankare

Prej funksioneve kryesore te bankës rezultojnë edhe llojet e punëve (operacioneve) bankare të cilat janë të shumta dhe të llojllojshme . Ndarja përkatesisht klasifikimi i punëve bankare bëhet sipas kritereve të ndryshme, por në praktik është pranuar klasifikimi :

1. Sipas kriterit të funksionit të punëve bankare,
2. sipas kriterit të afatit të punëve bankare
3. Sipas karakteristikave të bilancit analitik të punëve bankare .

2.5.1. Ndarja e punëve bankare sipas kriterit funksional

Ndarja e punëve bankare sipas kriterit funksional të tyre është bërë në baz të funksionit ekonomik të llojeve të ndryshme të punëve bankare . Sipas kriterit të funksionalitetit punët bankare mund ti ndajm :

1. **Punët e koncentrimit** dhe të grumbullimit (mobilizimit) të mjeteve monetare që në praktik shprehet me aktivitetin e bankes që të grumbullojë mjete monetare të ekonomisë nacionale
2. **Punët e krijimit të parave** që do të thot punët rreth krijimit të parave depozitare ose bankare me qëllim të funizimit të procesit të reproduksionit me sasinë e nevojshme të parave ,
3. **Punët e plastmanit të mjeteve** që kanë të bëjnë me punët e kreditimit, dhënien e garancionve, blerjen e letrave me vlerë etj,
4. **Punët administrative-kontrolluese dhe administrative-planifikuese**, ku bankat i kryejn disa punë në llogari të shtetit siq janë kontrolli devizor, shërbimi i evidencës dhe i statistikës. (Komoni, 2012)

2.5.2. Ndarja e punëve bankare sipas kriterit të afatit

Ndarja e punëve bankare sipas kriterit të afatit të burimeve dhe të plasmanit të mjeteve bazohen në ndarjen e mjeteve të reproduksionit në mjete themelore dhe qarkulluese. Nga aspekti i afatit punët bankare klasifikohen:

1. Në punët bankare **me afat te shkurter** , e që kryesisht kanë lidhje me sigurimin e burimeve të mjeteve qarkulluese për financimin e reproduksionit të thjesht, pra është fjala për burimin e mjeteve afat shkurtera dhe plasmanit afatshkurtër të tyre
2. Në punët bankare **me afat te gjate** e që kanë të bëjnë me sigurimin e mjeteve themelore dhe të mjeteve të përhershme qarkulluese për financimin e reproduksionit të zgjeruar, pra është fjala për punët e plasmanit me afat të gjat të mjeteve dhe me burimet e mjeteve me afat të gjat d.m.th mjeteve intensive.

2.5.3. Ndarja e punëve bankare sipas kriterit të bilancit analitik.

Nga ky aspekt punët bankare ndahen në:

1. **Punët bankare active ose kreditore** në të cilat banka paraqitet në funksionin e dhënësit të kredis , përkatësisht në rolin e kreditorit, prandaj këto punë gjithnjë paraqiten në anën e aktivës së bilancit të bankës në të cilën paraqiten kërkesat e bankës dhe quhen punë aktive bankare sepse banka realizon arkëtimin e normës të kamatës (aktive)
2. **Punët bankare pasive ose punët e mobilizimit**, janë kur banka paraqitet në funksionin e mbledhjes së mjeteve monetare dhe të marrjes së kredis d.m.th në rolin e debitorit, dhe regjistrohen në anën e pasivës së bilancit të bankës në formë të obligimeve dhe quhen punë pasive bankare, sepse banka iu paguan komiteteve një normë të kamatës (pasive)
3. **Punët bankare ndërmjetsuese, komisionare, shërbyese ose neutrale (indiferente)**, janë kur banka është as si debitor as si kreditor, por paraqitet si ndërmjetsues në mes të dy ose më shumë personave, në të cilat banka kryen ato punë

në emër të vet e në llogari të huaj, dhe për shërbimet e kryera nga ana e bakes,ajo arkëton (inkason) provizionin. (Komoni, 2012)

2.6. FUNKSIONET E BANKAVE

Funksioni i parë i bankave ishte këmbimi (ndërrimi) i parasë, pasi që atëherë kanë egzistuar lloje të ndryshme të parave metalike me kualitet dhe peshë të ndryshme. Pra bankat kanë linduar në bazë të punëve në lidhje me këmbimin e paras dhe të punëve depozitare. Si të tilla kanë kryer detyrën e arkëtimit, të ruajtësit, dhe të ndërmjetësuesit, kështu që punët e ndërmjetësimit, punët depozitare si dhe punët kreditore konsiderohen si funksionet kryesore të bankave.

Këto funksione në sisteme të ndryshme shoqërore-ekonomike kanë pasur rëndësi të ndryshme. Në sistemin shoqëror-ekonomik skllavopronar dhe feudal ishin të zhvilluar funksioni i ndërmjetësimit dhe i depozitimit, në sistemin shoqëror-ekonomik kapitalist funksioni më me rëndësi bëhet kreditimi si dhe zhvillimi në një shkallë më të lart i punëve depozitare dhe ndërmjetësuese.

Në pikëpamjen teorike dhe funksionale punët financiare të bankës rreth krijimit të parave si dhe të ndërmjetimit financiar jan funksionet themelore të bankës :

- Funksioni i krijimit të parave
- Funksioni i ndërmjetësimit
- Funksioni i istemit të pagesave

2.6.1. Funksioni i krijimit të parave

Do të thotë botimi i kartmonedhave si dhe krijimi i depozitave bankiere ose të parave-llogari. Krijimi i parave do të thotë krijimi i obligimeve që është një funksion i cili e përfshin edhe emisionin e parave të Bankës Qëndrore me të cilin krijohet baza monetare d.m.th paraja primare (emisioni primar). Krijimi (fabrikimi) i parave nga aspekti funksional paraqet

krijimin e obligimeve (marrjen e kredis). Banka Qendrore duke bërë emisionin e kartmonedhave krijo obligim në librat e veta ndaj të gjith pronarëve të katërmonedhave të cilat janë mjete ligjore të pagesave. Banka Qëndrore ose Banka emituese në bazë të pozitës monopoliste, si autoritet monetar i një vendi krijon të ashtëquajturat paratë primare, duke i dhënë kredi sektorit jobankar (sidomos shtetit) ose duke bler prej prej sektorit jobankar letrat me vlerë, ari dhe deviza ose duke bërë kreditimin e drejtpërdrejt të bankave.

2.6.2. Funkzioni i ndërmjetësimit financiar

Paraqet ndërmjetësimin e bankës në mes të sektoreve të ndryshme (organizatave ekonomike, shtetit, popullsisë etj), të cilët kanë tepric (suficit) të mjeteve financiare dhe të sektorëve të cilëve u mungojnë (deficit) mjetet financiare. Zakonisht disa sektorë kanë akumulimin apo kursimin më të madh të mjeteve se që janë investme reale të atyre dhe anasjelltas, disa sektorë akumulimin apo kursimin e kanë më të vogël se investimet reale të tyre

Funksioni ndërmjetësues i bankës ka të bëjë me mbledhjen (akumulimin) e mjeteve monetare prej organizatave të ndryshme, institucioneve, popullsisë si dhe subjekteve tjera, të cilat mjete për një kohë pronarët e tyre nuk kanë nevojë, dhe bartjen e tyre në ato subjekte të cilat kanë nevoj për ato para. Pra banka në mënyra të ndryshme bën mbledhjen apo koncentrimin e mjetve monetare, në q' rast banka paraqitet si kreditor, Marrja dhe dhënja e kredis paraqet funksionin e bankës, e cila nëpërmes të marrjes së kredis d.m.th të mbledhjes së mjeteve dhe të depozitave nga subjektet e shumta si dhe nëpërmes të dhënjes së kredisë organizative ekonomike dhe subjekteve të tjera, shihet roli, detyra dhe funksioni specific i bankës, e cila e bën që të dallohet prej organizatave tjera.

Funksioni i ndërmjetësimit përmban këto komponente të pavarura:

- ❖ Grumbullimi i mjeteve disponuese në kuader të një ekonomie kombetare,
- ❖ Transformimi i strukture së afatit të depozitave,
- ❖ Krijimi i metodave sa më efikase dhe racionale të grumbullimit e të lejimit të mjeteve monetare.

- ❖ Sigurimi i koncentrimin optimal te rrjedhave monetare me qellim te tejkalimit te kufizimeve territoriale, kohore dhe kufizimeve te destinimit.

2.7. Roli i Sektorit Bankar në Kosovë

Bankat në Kosovë veprojnë në një treg banker mjaftë profitabile, ku duke e ditur gjendjen ekonomike të Kosovës, numri nuk është mjaftë I madh, gjë që e bënë konkurrencën eproduktive bankare më të vogël dhe kjo drejtëpërdrejtë ndikon në shkallën e interes të bankave dhe vetë produkteve të bankave në përgjithësi. Sistemi Bankar Kosovar është një sistm relativisht I ri, por që pas vitit 1999 ka shfaqur një zhvillim të shpejtë. Open Data Albania ka kryer një hulumtim mbi sistemin banker në Kosovë, bazuar në të dhënat e Bankës Qëndrore të Republikës së Kosovës. I gjithë sistemi Bankar Kosovar është I privatizuar, dhe pjesa më e madhe e kapitalit zotërohet nga entitete të huaja (8 nga 10 Banka). Numri I bankave të huaja është rritur veçanërisht në 2008, kur u shtuan edhe dy Banka të reja. Gjithashtu bankat me capital të huaj kanë edhe pjesën më të madhe të sistemit (rreth 90%), ndërkohë që bankat me capital Vendas zënë vetëm 10 % të totalit të aktiviteteve. Pjesën më të madhe të aktiviteteve të sistemit banker e përbëjnë kreditë (58.5%). Ndërkohë në krahun e pasivit, depozitat kanë peshën më të madhe (rreth 79%), ndërkohë që kapitali I aksioneve zë rreth 9.3 % të totalit. (Academia.edu, 2008)



Figure 4 Sektori Bankar në Kosovë

Burimi: BQK (2019)

2.7.1. Sektori Bankar në Kosovë – Norma e interesit

Normat e interesit të kredive në Kosovë në vijimësi janë vlerësuar si të larta, si nga bizneset ashtu edhe nga amvisëritë. Megjithatë, në vitet e fundit ka pasur një përmirësim të ndjeshëm të kushteve të financimit nga bankat komerciale në Kosovë.

Sistemi bankar në Kosovë karakterizohet nga normat e larta të interesit të kredive, të cilat I kanë siguruar fitime të konsiderueshme bankave tregtare. Tregu bankar I Kosovës ka norma relativisht të larta për kreditë krahasuar me vendet e rajonit dhe kryesisht Shqipërinë, pavarësisht ritmit rënës të tyre në vitet e fundit. BQK bën të ditur se “rritja e normave të interesit, veçanërisht normat e interesit në kreditë për ekonomitë familjare, vlersohet të ketë qenë faktor I rëndësishëm në rritjen e depozitave”.

Dinamikat në afarizmin e sektorit ndikuan që performance financiare e sektorit bankar të jetë positive, edhe pse me një rritje marginale krahas periudhës së njëjtë të vitit të kaluar.

Aktiviteti kreditues I sektorit kryesisht u mbështet nga rritja e shënuar në burimet e brendshme, ku kategori dominuese janë depozitat. Për dallim nga tremujorët e kaluar, dominonin depozitat e transferueshme, këtë tremujor depozitat e afatizuara dominuan strukturën e gjithsej depozitave të sektorit.

2.7.2. Shërbimet Bankare

Sistemi bankar në Republikën e Kosovës është i ri. Funkzionimi i këtij sistemi filloi një vit mbas përfundimit të luftës. Mbase 90% të aseteve të bankave kryesisht janë të kapitalit të huaj. Përveç Bankës Qendrore funksionojnë edhe tetë Banka komerciale, në të cilën vetëm dy prej tyre janë me kapital vendor. Produktet kryesore të domosdoshme për një institucion financiar, për t'i përmbushur kushtet për të qenë bankë, janë punët e depozitave dhe të kredive, si dhe produktet e shërbimet e tjera e që në kohët e fundit janë duke u shtuar.

2.7.3. Depozitat dhe shpërndarja e tyre në sektorë

Në fund të vitit 2016 totali I depozitave në sistemin bankar në Kosovë arriti në 2.889.8 euro duke shënuar një rritje vjetore rreth 8.5 përqind. Që nga krijimi I sektorit bankar në Kosovë, çdo herë që ka pasur ngritje të depozitave, kjo është përcjellë nga një zvogëlim në numrin e kredive të lëshuara. Megjithatë, që nga viti 2010 për herë të parë rritja e kredive e ka tejkaluar rritjen e depozitave, dhe ky trend ka vazhduar edhe në vitin 2016.

2.7.4. Kreditë dhe shpërndarja e tyre në sektorë

Aktivitetet në sektorin bankar janë zgjeruar dhe pjesëmarrja e aktivitetit të kredive në BPV-në e Kosovës është rritur në 10.5%. Bazuar në të dhënat nga BQK, aktiviteti i kredive në bankat komerciale u karakterizua me një rritje të shpejtë. Pavarësisht nga kriza Europiane e borxhit, ku bankat europiane janë ballafaquar me mungesën e besueshmërisë nga klientët, profiti I bankave në vend tregon që bankat në Kosovë edhe më tutje kanë profit mbi mesataren e rajonit.

2.7.5. Likuiditeti i Bankave

Rritja e numrit të depozitave dhe bilancet e kredive të papaguara paraqesin dëshmi që sektori bankar në Kosovë vazhdon të kontribuojë në rritjen ekonomike të vendit duke e rritur rolin e vet si ndërmjetsues financiar. Kjo është e evidente nga rritja e vazhdueshme e disa indikatorëve si pjesëmarrja e asetëve të sektorit bankar, depozitat dhe kreditë në BPV. E interesit – mesatar.

2.7.6. Aplikimet për licencimin e bankave të reja

Numri I bankave komerciale në tregun financiar në Kosovë mbeti I pandryshuar gjatë tri viteve të fundit, pavarësisht nga fakti që kjo industri konsiderohet të jetë shumë profitabile dhe e vazhdimisht I ka zgjeruar aktivitetet, e cila paraqet faktor të rëndësishëm për tërheqjen e institucioneve të reja financiare për të hyrë në treg.

Megjithatë, sipas BQK-së, mungesa e hyrjeve të bankave të reja në tregun financiar në Kosovë, gjithashtu korresponon me zhvillimet e krizës financiare globale që nga viti 2008, e cila ka limituar zgjerimin e mëtutjeshëm të institucioneve financiare të huaja ndaj tregjeve të reja. Një ndikim i njejtë është duke u shkaktuar nga kriza monetare e borxheve publike në Eurozonë, e cila ka goditur një numër të madh të bankave në Unionin Evropian. Përveç kësaj, janë shumë pengesa për bizneset në Kosovë të cilat konsiderohen si skajshmërisht të pafavorshme dhe mund të kontribuojnë në mungesën e interesimit nga investitorët tjerë të investojnë në Kosovë. (Al., 2010)

2.8. Përshkrimi I Rezultatit të Hulumtimit

Në këtë kapitull do të prezentohen rezultatet nga anketa e kryer. Pas çdo pjese të të gjeturave, këto rezultatet do të analizohen dhe të diskutohen në lidhje me literaturën akademike. Qëllimi është që sipas pyetjes kërkimore të shqyrtojmë Sistemin Financiar në Kosovë. Pas një prezentimi të shkurtër të arsyeve dhe qëllimeve të metodologjisë do të prezentohen mostra, karakteristikat e të intervistuarve, instrumentet kërkimore dhe analiza e pyetjeve të pytsorit.

Table 1 Gjinia e të anketuarve

F	M
27	33




Figure 5 Përqindja e Gjinisë të anketuarve

Table 2 Moshë e të anketuarve

18 – 30	30 – 60	Mbi 60
33	16	1

Moshë juaj?

50 responses




Figure 6 Përqindja e moshës së të anketuarve

Table 3 A keni ndëgjuar për sistemin financiar në Kosovë

PO	JO
39	11




Figure 7 Përqindja se a keni ndëgjuar për sistemin financiar në Kosovë

Table 4 Sa jeni të kënaqur me sistemin financiar në Kosovë

Shumë	Pak	Aspak	Deri Diku	As pak as shumë	Deri diku jo shumë	Mjaftueshmëm
9	30	7	1	1	1	1

50 responses




Figure 8 Përqindja se sa jeni të kënaqur me sistemin financiar në Kosovë

Table 5 A mendoni se ka pasur përmirsim në sistemin financiar më Kosovë

Shumë	Pak	Aspak
6	35	9




Figure 9 Përqindja se a mendoni se ka pasur përmirsim në sistemin financiar në Kosovë

Table 6 A mendoni që BQK do të ndikonte në përmirsimin e sistemit financiar në Kosovë

Shumë	Pak	Aspak
43	7	0




Figure 10 Përqindja se a mendoni që BQK do të ndikonte në përmirsimin e sistemit financiar në Kosovë

Table 7 Si e vleroni sistemin financiar në Kosovë ju qytetarë

1 Aspak	2	3	4	5 Shumë
5	9	21	10	5




Figure 11 Përqindja se si e vleroni sistemin financiar në Kosovë ju qytetarë

Table 8 Sa shpesh përballeni me probleme në këtë fushë

Çdoherë	Shpeshherë	Asnjëherë
15	30	5




Figure 12 Përqindja se sa shpesh përballeni me probleme në këtë fushë

Table 9 A mendoni që do të ketë përmirsim sistemi financiar në Kosovë në vitin 2021

Shumë	Pak	Aspak
12	33	5




Figure 13 Përqindja se a mendoni që do të ketë përmirsim sistemi financiar në Kosovë në vitin 2021

3. DEKLARIMI I PROBLEMIT

Në këtë punim, u trajtua në pika të shkurtra Sistemi Financiar në Kosovë, Menaxhimi dhe politikat bankare, dhe si pika kyçe të këtij punimi ishin me theks të veçantë, - Roli i sistemit financiar në Kosovë. Esenca e këtij punimi ka qenë analiza e gjendjes aktuale të Sistemit financiar në Kosovë dhe reformat që duhet ndërmarrë në përmisimin e gjendjes aktuale. Nga kjo analizë e bërë është arritur si përfundim se shërbimet bankare sot në Kosovë shfrytëzohen mjaft mirë nga bizneset private dhe klientura e gjerë.

Sistemi financiar i Kosovës mbetet kryesisht i bazuar në sektorin bankar, i cili ka rolin kryesor në mobilizimin e kursimeve dhe alokimin e tyre të huamarrësit. Niveli i lartë i besimit të publikut në sistemin bankar, i ndërtuar mbi bazën e funksionimit të shëndoshë të këtij sistemi ndër vite, edhe gjatë vitit 2016 ka pasur rol kyç në mobilizimin e kursimeve dhe rritjen e përshpejtuar të depozitave të mbledhura brenda vendit. Rritja e qëndrueshme e këtyre depozitave bëri të mundur që sektori bankar të ketë mjete të mjaftueshme për shtrirjen e mëtejme të kreditimit në ekonominë e vendit. Në vitin 2016 aktiviteti kredidhënës i sektorit bankar është rritur me ritëm të përshpejtuar, duke shërbyer kështu si një financues i rëndësishëm i rritjes së ekonomisë së vendit.

Me gjithë rritjen e vazhdueshme të kreditimit bankar në raport me Bruto Produktin Vendor mbetet ende në nivel më të ulët krahasuar me mesataren e vendeve të rajonit dhe me vendet e zhvilluara, gjë që nënkupton hapësirë të mëtejme për rritjen e ndërmjetësimit financiar në Kosovë.

Sidoqoftë, krahas rritjes së vëllimit të kreditimit ekonomia e vendit ka nevojë edhe për një diversifikim më të madh të strukturës së kreditimit bankar në favor të rritjes së kreditimit për sektorët që mund të gjenerojnë më shumë vlerë të shtuar, siç janë sektorët e prodhimit dhe bujqësisë, por edhe sektorët e tjerë të shërbimeve (të ndryshëm nga tregtia).

4. METODOLOGJIA

Metodologjia është një mjet i dobishëm për të shkruar një hulumtim, metodologjia e përdorur në këtë punim për mbledhjen e të dhënave klasifikohet në dy kategori ato janë të dhënat primare dhe ato sekondare, ndërsa metodat e përdorura janë metoda kualitative dhe kuantitative.

Metodologjia e përdorur në këtë hulumtim bazohet në disa hapa të cilët duhet ndjekur:

- Krijimi i pyetësorit,
- shpërndarja e pyetësorit,
- mbledhja e të dhënave,
- Përpunimi dhe analizimi i të dhënave.

Metoda më e aplikuar gjatë këtij punimi është metoda kualitative duke u mbështetur në literaturën përkatëse si dhe mbledhja e të dhënave me anë të pyetësorit të krijuar për mbledhjen e të dhënave i cili shërben si indikator matës i saktë për fushën të cilën po hulumtohet.

Krijimi i pyetësorit është bazuar në problemin hulumtues të cilin e trajton ky hulumtim, para publikimit të pyetësorit është siguruar që ai pyetësor është adekuat, i kuptueshëm dhe që sjell rezultatet e dëshiruara, kjo metodë është përdorur për arsye se është më e besueshme në masë. Lloji i pyetësorëve të cilët do të përdoren për qëllim të grumbullimit të të dhënave për këtë studim do të jetë i mbyllur. Për mes këtij pyetësori pretendohet të arrihet të mbledhë të dhëna nga Institucionet financiare Banke që operojnë në Komunën e Ferizajt, konkretisht me personat përgjegjës në këto institucione.

Pyetësori në vete përmban 9 pyetje, të cilave do ju përgjigjen persona të grup moshave të ndryshme. Madhësia e mostrës është një tipar i rëndësishëm i çdo studim empirik në të cilat qëllimi është për të bërë konkluzione në lidhje me studimin e caktuar. Një çështje e rëndësishme mbi të cilën mbështet punim do të jetë mostra dhe numri i respondentëve të cilët do të përfshihen për qëllime të këtij studimi. Në parim sa më i madh që të jetë numri i mostrës I respondentëve të përfshirë gjatë fazës dhe procesit të këtij hulumtimi aq më shumë do të rritet shkalla e cilësisë në lidhje me besueshmërinë e të dhënave. Vlerësimi i madhësisë së numri të respondentëve, bazohet në supozimin që nuk mund të jetë gjithmonë i saktë. Zonë e

studimit në këtë punim do të jetë komuna e Ferizajit, pyetësi do të shpërndahet tek 50 respondent dhe planifikohet që të dhënat të mblidhen brenda 10 ditëve.

5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Sipas Raporteve të publikuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), ka njoftuar se sistemi financiar i Kosovës ka vazhduar të reflektojë nivel të lartë të qëndrueshmërisë në të gjithë sektorët përbërës të tij. Sipas BQK-së, sektori bankar, si përbërësi kryesor i sistemit financiar të Kosovës, ka ruajtur nivelin e qëndrueshmërisë, përdërisa aktiviteti ndërmjetësues financiar ka vazhduar të rritet por me ritëm të ngadalësuar. Në Raportin e Stabilitetit Financiar të BQK-së, thuhet se përmirësimi i treguesve kryesor makroekonomik në Kosovë, krahasuar me vitin e kaluar, paraqet shenja inkurajuese për ambientin afarist në vend, por që nuk ka ndikuar në rritjen e gatishmërisë së sektorit bankar për një zgjerim më të shpejtë të kredihënies drejtë ekonomisë vendore.

Ja disa rekomandime për të kontribuar në zhvillimin e industrisë dhe për të kapur shanset në Kosovë duke përdorur analitikën e avancuar:

- Të imponohet analitika e avancuar për të gjitha proceset e vendimmarrjes;
- Të pranohet vlera e analizës së riskut dhe të futet në axhendën kryesore strategjike;
- Të formohet struktura organizative me ekipe të pavarura dhe të kualifikuara të analitikës, të veçohet analitika e riskut nga funksionet tjera;
- Të përpunohen të gjitha të dhënat e brendshme të cilat janë të disponueshme dhe të shëndosha, të konsiderohet si opsion eksternalizimi i shërbimeve për ekspertizë analitike;

Sektori bankar i Kosovës, siguron një stabilitet të qëndrueshëm financiar, duke gërshetuar me një dominim total të bankave të huaja, të cilat kanë një capital nga vendet e ndryshme të Europës. Roli i sektorit bankar të Kosovës në ekonomisë e saj nuk sjell rritje ekonomike, varfëron qytetarët e varfër të Kosovës, ngulfat familjet dhe bizneset kosovare me norma të larta të interesit dhe me kohëzgjatje të shkurtër të kthimit të kredisë, nuk hapë mundësi të kategorizimit të kredive, duke ofruar kredi të profilizuara në rritje, ngadalëson zhvillimin ekonomik të Kosovës, krijon mangësi në sektorin financiar të Kosovës, ndërsa nga ana e bankave kjo situatë është në horizont të kundërt me efektin që kanë në ekonominë e Kosovës, ku kanë profit të lartë nga komitentët e tyre, sigurojnë stabilitet financiar dhe likuiditet për

bankat e tyre, krijojnë bazë për rritje të kredive të këqija, këto mund të jenë disa nga efektet që ka sjell dhe që po sjell sektori banker në Kosovë.

REFERENCAT

Agalliu. A, (2012), *Audituesi Financiar*, Revista Bankieri

Augustine, O. Enofe, Chijioke Mgbame, Sadiq, O. Akhor & Francis, A. Okungbowa (2013),

Internal Control System and Quality Audit Work. Research Journal of Finance and

Accounting Vol.4, No.13, 2013

Jakupi dr. Shefket, Shehu dr. Hidajet “*Revizioni Financiar dhe Kontrolli i Proceseve Afariste*

në Ndërmarrje” Prishtinë, Tetor, 2011

Komoni, S (2012) “*Financat*”, Prishtinë

Limani, M (2002) “*Hyrje ne Ekonomi*”, Prishtinë

Limani, M (2011) “*Mikroekonomia*”, Prishtinë

Luboteni, G (2008) “*Menaxhmenti Bankar*”, Prishtinë

Ndiqparate.al. 2021. *Open Data Albania*. [Online] Available at: <<http://ndiqparate.al/>>

[Accessed 31 March 2021]

Bqk-kos.org. 2021. *Banka Qendrore e Republikës së Kosovës / Banka Qendrore e Republikës*

së Kosovës. [Online] Available at: <<https://bqk-kos.org/>> [Accessed 31 March 2021].

Mpra.ub.uni-muenchen.de. 2021. [Online] Available at: <<https://mpra.ub.uni>

[muenchen.de/24536/1/MPRA_paper_24536.pdf](https://mpra.ub.uni-muenchen.de/24536/1/MPRA_paper_24536.pdf)> [Accessed 31 March 2021].

Scribd.com. 2021. [Online] Available at:

<<https://www.scribd.com/doc/115244221/SISTEMI-BANKAR-NE-KOSOVE-1>>

[Accessed 31 March 2021].

SHTOJCA

Pyetësor

SISTEMI FINANCIAR NË KOSOVË

Gjinia?

F

M

Mosha? *

18-30

30-60

Mbi 60

A keni ndëgjuar për sistemin financiar në Kosovë? *

Po

Jo

:

A mendoni se ka pasur përmirsim në sistemin financiar në Kosovë

- Shumë
- Pak
- Aspak

A jeni të kënaqur me sistemin financiar në Kosovë *

- Shumë
- Pak
- Aspak

A mendoni që BQK do të ndikonte në përmirsimin e sistemit financiar në Kosovë *

- Shumë
- Pak
- Aspak

Sa shpesh përballeni me probleme në kë fushë

- Çdoherë
- Shpeshherë
- Asnjëherë

Si e vlersoni sistemin financiar në Kosovë ju si qytetarë *

	1	2	3	4	5	
Aspak	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	Shumë